

Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit drejt inkuadrimit social dhe qytetarisë aktive





**Iniciativa qytetare e femrave
ANTIKO**

Praktika dhe përvoja të mira nga projekti i inkuadrimit social të grave nga bashkësitë etnike joshumicë nga mjediset rurale në R. e Maqedonisë

**“Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit
drejt inkuadrimit social dhe
qytetarisë aktive”**

BOTUES:
Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO

Për botuesin :
Gjyner Nebiu

Autorë:
Gjyner Nebiu,
Ivana Srceva ,
Danica Jovanova

Përkthyes dhe lektor : Besnik Emini

Ilustrimi i kopertinës - Jetmire Zendeli

Dizajni grafik: PROPOINT

Shkup, 2011

Ky publikim është përgatitur me përkrahje të Trupës së KB-së për barazi gjinore dhe avancim të grave UN Women
Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve, të njëjtat domosdo nuk i paraqesin mendimet dhe qëndrimet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose organizatave tjera shoqëruese



United Nations Entity for Gender Equality
and the Empowerment of Women

Përgatitja dhe shtypja e këtij publikimi është pjesë e projektit “Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit drejt inkuadrimit social dhe qytetarisë aktive – faza I & II” i cili u zbatua nga Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO



Iniciativa Qytetare e Femrave Antiko është rrjet ndëretnik i 18 organizatave dhe grupeve lokale shumetnike në Republikën e Maqedonisë, të cilat punojnë në promovimin e kulturës së paqes dhe ndërtimit të bashkësisë nëpërmjet angazhimit publik dhe shoqëror të grave nga më shumë bashkësi etnike.

IQF Antiko përpiqet për afirmim të të drejtave dhe jetës së njeriut/ grave pa dhunë, si në kuadër të familjes, ashtu edhe në jetën shoqërore. Organizata jonë veprimin e saj e mbështet mbi vlerat e jodhunës, tolerancës, multikulturalizmit, barazisë, sigurisë, zhvillimit të qëndrueshëm, përkrahjes, rrjetëzimit, aktivizimit qytetar, drejtësisë sociale dhe inkuadrimit.

IQF Antiko, në fushën e veprimit të saj ka arritur rezultate dhe ndryshime të dukshme pozitive në nivel lokal dhe nacional:

-kontribut ndaj inkuadrimit të perspektivës gjinore në politikën dhe programet e institucioneve, NJBL-së, partive politike (lobim dhe përfaqësim për avancim të rregullave ligjore, analiza dhe hulumtime, përforsim të kapaciteteve të grave anëtare të partive politike dhe anëtarëve të tyre të rinj, anëtarëve të KMB-së në nivel lokal, administratës lokale dhe aktorëve të tjerë kyçë në bashkësi);

-përfshirje sociale dhe motivim të aktivizimit të gratë e mjedisve rurale nëpërmjet përforsimit të kapaciteteve të tyre për identifikim të problemeve dhe zbatim të aksioneve në bashkësi, e tëra me qëllim që të avancohet dhe përmirësohet statusi dhe pozita e grave në mjediset rurale;

-përforsim social dhe ekonomik i grave – ndërtimi i kapaciteteve, edukim dhe përkrahje të grave dhe grupeve të marginalizuara për

pjesëmarrje aktive në proceset shoqërore dhe ekonomike

-kontribut ndaj ndërtimit të paqes nëpërmjet të promovimit të jod-hunës, bashkëpunimit shumetnik dhe afirmimit të ideologjisë dhe politikës gjinore (feministe) në arritjen e barazisë gjinore në kuadër lokal dhe global.

Programi vjetor i ANTIKO-s është përkrahur nga programi CIVICA Mobilitas, i cili është zbatuar nga ana e Qendrës për Zhvillim Institucional – CIRa dhe i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e përfaqësuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Maqedoni.

Parathënie

Arritja e shoqërisë së përfshirjes është dëshirë shoqërore e cila ka për qëllim të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë, pa i marrë parasysh dallimet ekzistuese. Të jetuarit me dinjitet nuk është vetëm normë etike dhe imperativ moral, por edhe parim i drejtë i promovimit të angazhimit qytetar për pjesëmarrje të barabartë të gjinive në zhvillimin e bashkësisë.

Njëra nga çështjet e rëndësishme dhe me prioritet për zhvillimin e proceseve demokratike, drejtësisë sociale dhe paqes së qëndrueshme në vendin tonë dhe në korniza globale, është përforsimi dhe krijimi i mundësive të njëjta për gratë dhe burrat. Kjo është posaçërisht e rëndësishme gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve të ndjeshme gjinore për përforsimin e grave të grupeve të marginalizuara dhe të ndjeshme nga grupet etnike joshumicë të mjediseve rurale, të cilat janë shumëfish të diskriminuara – të shkyçura nga jeta publike, ekonomike, politike dhe kulturore e bashkësisë dhe vendit, në përgjithësi.

Pozita e grave në Maqedoni ende mbështetet në norma dhe vlera tradicionale dhe patriarkale. Edhe pse në mjediset urbane ekziston tendenca për ndryshim të raporteve tradicionale në shtëpi, kjo për fat të keq është rast shumë i rrallë me gratë e mjediseve rurale. Ata shumë shpesh janë viktimë e të gjitha llojeve të dhunës dhe ballafaqohen me mbrojtje dhe parandalim joadekuat. Të drejtat dhe prioritetet e tyre shpesh janë pamjaftueshëm të adresuar në strategjitë nacionale për zhvillim të barazisë gjinore. Gratë e këtyre mjediseve shpesh ballafaqohen me varshmëri ekonomike, shkallë të lartë të mosaktivitetit shoqërorë, papunësi, mundësi të kufizuara për ndihmë financiare, informata dhe arsimim, mbrojtje të papërshtatshme shëndetësore dhe qasje në shërbimet shëndetësore (veçanërisht për shëndetin reproduktiv), qasje të pamjaftueshme në arsimimin joformal, shkelje të së drejtës për lidhje të martesës

(martesa të marrëveshjes) dhe të tjera.

Për pozitën e tyre të pavolitshme flasin edhe Komentet – rekomandimet përmbyllëse të raportit CEDAW, të Komitetit të OKB-së për Republikën e Maqedonisë (2006, veçanërisht në pikat 27, 28) ku qartë shihet brengosja.

Duke e pasur parasysh të lartpërmendurën, Iniciativa Qytetare e Femrave Antiko, si rrjet shumetnik i femrave dhe organizatave të cilat punojnë aktivisht në fushën e avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të femrave dhe arritjes së barazisë mes femrave dhe meshkujve , ndërmori nismë dhe me përkrahjen e UN Women (nga maji i vitit 2009 deri në shkurt të vitit 2011) e realizoi projektin **“Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit drejt inkuadrimin social dhe qytetarisë aktive”**.

Rezultatet e arritura në të kaluarën, na kanë dhënë guxim të ndërmarrim lloj të këtyllë të nismës. Kjo për ne, anëtarët dhe ekipet e Antiko-s, ishte sfidë e madhe. Metodologjia e punës të cilën e zbatuam paraqet njëherë nga qasjet më gjithëpërfshirëse, por edhe proces të vështirë për t'u realizuar veçanërisht për implementim në grupe synuese të cilat janë shkajshëmërisht të marginalizuara.

Duke iu falënderuar përvojës sonë 11 vjeçare me këtë lloj të punës, i arritëm rezultatet e dëshiruara. Prandaj, nëpërmjet kësaj broshure vendosëm që praktikën dhe përvojat e mira, t'i ndajmë me të gjitha OJQ-të dhe palët tjera të prekura të cilat dëshirojnë ta japin kontributin e tyre për përmirësim të pozitës së këtyre grupeve dhe grupeve të tjera të marginalizuara në bashkësi.

Grupi programor i projektit

Hyrje

Politika e barazisë gjinore dhe e forcimit të grave paraqet njërin nga parimet themelore të demokracisë dhe rendit shoqëror. Barazia gjinore në Republikën e Maqedonisë është e garantuar me Kushtetutën e vitit 1991 dhe si e drejtë themelore e njeriut paraqet një nga qëllimet dhe parimet më të rëndësishme të shtetit. Puna ndaj qëllimit për arritje të barazisë së vërtetë gjinore dhe ballafaqim me pabarazitë ekzistuese, shpesh do të thotë të punohet ndryshe me gratë dhe burrat dhe të pranohet se ata kanë nevoja, prioritetet dhe aspiratat të ndryshme, ballafaqohen me pengesa të ndryshme dhe kontribuojnë drejt zhvillimit në mënyra të ndryshme.

Në këtë kontekst gratë duhet të arrijnë barazi që të mund të punojnë në emër të vet, me zë të fortë të luftojnë që pikëpamjet e tyre të jenë të dëgjueshme dhe të merren parasysh. Së këndejmi, rritja e inkuadrimin të grave në konsultimet dhe në sjelljen e vendimeve në të gjitha nivelet do të kontribuojë për zhvillimin e barazisë gjinore në fushat e ndryshme të jetës.

Sipas Entit të Statistikës 86,7% i territorit të Republikës së Maqedonisë është rural dhe paraqet shtëpi për 40,2% të popullsisë së tërësishme në vend. Gratë e mjediseve rurale më së shpeshti u takojnë bashkësive etnike joshumicë dhe të njëjtat janë të marginalizuara, të shkyçura nga jeta socio-ekonomike, publike dhe politike e bashkësive të tyre. Për këtë gjendje kontribuojnë një numër i madh i faktorëve, siç janë mjedisi patriarkal, rolet gjinore stereotip, varfëria etj. Identiteti gjinor, i lidhur me përkatësinë e tyre etnike dhe vendin e të jetuarit të tyre e bënë këtë grup posaçërisht të ndjeshëm. Sipas kësaj, gëzimi i të drejtave themelore, si edhe qasja deri te arsimimi, informatat, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, punësimi, pjesëmarrja në jetën publike dhe politike të bashkësisë, mbetet interes primar i secilit aksion i cili i synon gratë e mjediseve rurale.

Në Republikën e Maqedonisë numri më i madh i grave të cilat jetojnë në mjediset rurale më së shpeshti janë të papuna, amvise të cilat kujdesen për shtëpinë, bagëtinë dhe fushën, nuk posedojnë tokë, pronë ose biznes dhe nuk kanë qasje deri te kreditë e volitshme zhvillimore.

Pjesëmarrja e grave në sjelljen e vendimeve, planifikimit bujqësor dhe prodhimit të tërësishëm rrallë është hulumtuar. Papunësia, qasja e vështirësuar në institucionet dhe shërbimet, informimi i pamjaftueshëm, infrastruktura e keqe dhe pasiguria në treg janë të identifikuara si probleme themelore për gratë të cilat jetojnë në fshat, që në mënyrë plotësuese ndikon ata të mbeten në zonat rurale dhe të punojnë në fushën e bujqësisë.

Tranzicioni nëpër të cilin kalon Republika e Maqedonisë ka efekte negative, e posaçërisht në pozitën ekonomike të grave, punësimit të tyre dhe vlerësimin të punës së tyre. Së këndejmi, sipas Entit të Statistikës, vetëm 4% e grave të punësuarja janë pronare të bizneseve, 11% e grave të punësuarja paguhen me rrogë mbi mesataren në vend, ndërsa shkalla e papunësisë të gratë është 37,2%. Sipas strukturës së moshës më e madhe është përqindja e grave të papunësuarja të cilat bëjnë pjesë në kufirin e moshës prej 25 deri në 29 vjet, kur edhe janë më të afta për punë.

Informata të përgjithshme për projektin

Projekti i IQG Antiko “Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit drejt inkuadrimin social dhe qytetarisë aktive – faza I dhe II” i cili është përkrahur nga UN Women (paraprakisht UNIFEM), ka për qëllim ta përforcojë identitetin e gruas, fuqinë dhe vetëbesimin e grave të mjediseve rurale, vetëdijesimin, forcimin, motivimin e tyre dhe dhënien e përkrahjes për inkuadrim aktiv në jetën publike dhe sociale të bashkësisë.

Grupin synues të këtij projekti e përbëjnë gra nga mjediset rurale të cilat u takojnë grupeve të ndryshme etnike (maqedonase, shqiptare, turke, maqedonase myslimane, rome) në moshë prej 17 deri në 40 vite nga komuna e Mogilës, Tearcës, Likovës, Krushevës, Dibrës dhe Gostivarit.

Në fazën e parë të zbatimit të aktiviteteve projektuese ekipet lokale të Antiko-s ishin të përfshirë në mbledhjen e të dhënave nga terreni nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e bashkëqeverisjes lokale, qendrave të punës sociale dhe burimeve të tjera relevante, të cilat mundësojnë të vihet deri te informatat, të dhënat dhe konstatimet e caktuara në raport me gjendjen e grave nga bashkësitë rurale. Varësisht nga kuantiteti dhe kualiteti i të dhënave të fituara nga ana e ekipeve lokale, është përgatitur analizë individuale për secilën nga komunat e parapara (Likovën, Tearcën, Mogilën, Gostivarin dhe Dibrën).

Kjo analizë e ekipeve lokale, por edhe e ekipit programor të Antiko-s shërbyen si bazë e të dhënave për përcaktimin fillestar të gjendjes, krijimit të programeve adekuate edukative, por edhe fitim të informatave sa institucionet relevante disponojnë me të dhëna gjinore të segreguara dhe sa ato i kushtojnë vëmendje pozitës së grave në komunën e tyre.

Në kuadër të projektit “Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit drejt

qytetarisë aktive dhe inkuadrimit social” (në fazën e parë dhe të dytë) ku u inkuadruan gjithsej gjashtë komuna rurale: Tearca, Mogila, Likova, Krusheva, Dibra dhe Gostivari¹, qëllimi kryesor ishte rritja e numrit të grave nga mjediset rurale të bashkësive të ndryshme etnike të cilat janë të vetëdijshme, i dallojnë të drejtat e tyre të grave/njerëzore dhe ndërmarrin nisma për krijimin e ndryshimeve në nivel personal, në nivel të grupit dhe bashkësisë, e tëra me qëllim të zvogëlimit të vlerave tradicionale dhe rritjes së pjesëmarrjes së tyre aktive në jetën socio-ekonomike dhe politike të bashkësisë.

Faza vijuese ishte organizimi i punëtorive. Punëtoritë edukative u realizuan me qasjen: edukim – motivim dhe përkrahje në aksion.

Mësimi me përvojë, motivimi pozitiv në tema për të drejtat e njeriut/ grave, koncepte gjinore, teknika të lobimit dhe përfaqësimit publik, përvetësimit të shkathtësive për planifikim dhe zbatim të aksionit publik – kontribuuan për vetëdijësimin, informimin, inkurajimin gjinor, rritjen e diturive dhe shkathtësive të grave të këtyre grupeve të marginalizuara që qartë t’i identifikojnë – të krijojnë hartën e problemeve dhe nevojave të tyre në bashkësi dhe në mënyrë aktive të inkuadrohen në zgjidhjen e të njëjtave nëpërmjet inicimit, planifikimit dhe zbatimit të aksioneve publike në tema aktuale dhe në çështje me prioritet për to.

Në përpjekjet e tyre gratë arritën t’i interesojnë dhe në mënyrë aktive t’i inkuadrojnë edhe palët e tjera të prekura në bashkësi. Ata organizuan aktivitete të shumta në tema të cilat më së shumti i prekin ata. Qëllimi i tyre kryesor ishte të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së të jetuarit të tyre dhe realizimit të të drejtave të tyre themelore/njerëzore/të grave. Me përkrahjen e ekipeve të Antiko-ata vendosën bashkëpunim me kryetarët e komunave dhe institu-

1 Edhe pse Krusheva, Dibra dhe Gostivari janë mjedise qyteti në këta komuna u punua me gratë e mjedisëve rurale të cilat u takojnë komunave, respektivisht Krushevës – Jakrenovë, Borinë, Belushinë dhe Lazhani, Dibrës - Mogorçë, Broshticë, Xhepisht, Otishan dhe Gostivarit – Çegran, Forinë, Belovisht, Balindoll

cionet relevante të pushtetit lokal, me çka i aktualizuan para publikut problemet dhe nevojat ekzistuese e tëra me qëllim që të ndikojnë në krijimin e politikave të ndjeshme gjinore, të cilat do t'i marrin parasysh nevojat gjinore.

Në aksionet e ndërmarra nga ana e grupeve synuese në të 6 komunat, u arrit sukses shumë i rëndësishëm. Me këtë qasje dhe mënyrë të punës, rezultatet e pritura të projektit “Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit drejt inkuadrimit social dhe qytetarisë aktive” u arritën në tërësi.

Metodologjia e punës:

Instrumente kryesore të cilat u shfrytëzuan në punëtoritë edukative dhe në fazat tjera të projektit janë: mësimi me përvojë, pjesëmarrja aktive, ndërveprimi dhe bashkëpunimi, motivimi pozitiv, dëgjimi aktiv, shkathtësitë e dhënies së informatës kthyesë, krijimi i ekipit, puna praktike – planifikimi dhe zbatimi i aksioneve në bashkësi nëpërmjet lidhjes së ndërsjellë – rrjetëzimit. Hapat gjatë zbatimit të aktiviteteve projektuese u realizuan sipas metodologjisë vijuese:

- Mbledhja e informatave dhe përpilimi i raportit me vështrim në gjendjen faktike të grave nga mjediset rurale nga bashkësitë etnike joshumicë në komunat e parapara (Tearcë, Dibër, Gostivar, Krushevë, Likovë dhe Mogilë);
- Organizimi i cikleve të punëtorive edukative;
- Identifikimi (krijimi i hartës) i problemeve dhe nevojave të grave në bashkësi nga ana e grupit synues me qëllim të inkuadrimit të tyre të mëtejshëm në jetën publike dhe shoqërore;
- Zbatimi i aksioneve të ndjeshme gjinore lokale në problemet dhe nevojat e krijuara në hartë;
- Lobimi, përfaqësimi publik dhe vendosja e bashkëpunimit me Vetëqeverisjen Lokale – kryetarët e komunave dhe institucionet relevante;
- Sjellja e përfundimeve dhe rekomandimeve për aktivitete të mëtutjeshme dhe forma të punës efektive dhe përkrahjes nga ana e të gjitha institucioneve relevante në raport me zgjidhjen e problemeve dhe nevojave të grave nga pakicat etnike.

Punëtori edukative

Duke u nisur nga analiza e të dhënave të mbledhura në teren dhe përvojës së fituar të Antiko-s me veprim 11 vjeçar grass-rot në bashkësitë lokale në Maqedoni, vendosi të dizajnojë **module edukative** në tema të cilat do t'i vetëdijesojnë, forcojnë dhe motivojnë gratë e mjediseve rurale për tejkalim të disa paragjytimeve, stereotipave dhe vlerave tradicionale të pranishme në këto bashkësi në raport me gratë dhe rolet e tyre gjinore. Kjo ishte sfidë e madhe për ekipin programor të Antiko-s dhe ekipeve të saja lokale të cilat në mënyrë aktive veprojnë në 10 bashkësi lokale në R. e Maqedonisë.

Metodologjinë e punës dhe strategjinë për inicim të ndryshimeve nëpërmjet edukimit – përforcimit – përkrahjes – aksionit në bashkësi – vendosjen e bashkëpunimit me palë të tjera të prekura dhe pushtetit lokal, e zbatojmë që nga fillimi i themelimit dhe veprimit tonë me të cilat kemi arritur rezultate të mëdha. Kjo posaçërisht ka të bëjë me gratë e partive politike, gratë këshilltare, forumet e grave dhe forumet rinore të partive politike, sindikatat, OJQ-të dhe të tjera. Por, këtë metodologji për herë të parë e zbatojmë me grup synues i cili është shumë i lëndueshëm (me shkallë të lartë të shkyçjes sociale, të izoluar dhe “funksionalisht analfabete”).

Rrezikun të cilin e ndërmorem ishte i lartë, por ishim të vetëdijshëm se duhet të investojmë përpjekje maksimale, sepse procesi është i vështirë, por sukseset nuk janë të pamundura nëse besojmë në atë që e punojmë dhe nëse dëshirojmë të iniciojmë ndryshime dhe të arrijmë sukses të caktuar, i cili do t'i inkurajojë gratë e këtyre bashkësive të promovojnë modele më të ndryshme të sjelljes, ndërsa të njëjtat të jenë njëkohësisht të pranuar edhe nga aktorët tjerë në bashkësi.


Ne besojmë se për realizim të suksesshëm të këtij projekti duhet të veprojmë paralelisht në më tepër nivele: t'i vizitojmë gratë dhe burrat në shtëpitë e tyre ("nga dera në derë"), të bisedojmë me ta, ta fitojmë besimin e tyre që të marrin pjesë në punëtoritë tona, ndërsa familjet e tyre, vetëqeverisja lokale dhe faktorët e tjerë vendimtarë të jenë aleatë dhe bashkëpunëtorë tanë dhe të tyre. Nuk ishte as lehtë as thjeshtë, por sido që të jetë, ekipi ynë i projektit dhe ekipet lokale (të cilat kaluan TOT shtesë për riedukim për lloj të këtyre të veprimit) investuan përpjekje maksimale dhe me sukses e realizuan këtë detyrë. Ishim këmbëngulës dhe besojmë se kjo është rruga e vetme të arrijmë sukses.

Procesi zhvillohej paralelisht në më shumë drejtime. Punëtori me gra, mbledhje me kryetarë komunash dhe institucione relevante – nënshkrim të Memorandumeve për bashkëpunim dhe mbajtje të punëtorive me administratën lokale dhe këshilltarët dhe këshilltarët e kuvendeve komunale. Në zbatimin e këtyre aktiviteteve paralele u inkuadruan edhe ekipi programor dhe koordinues i Antiko-s nga zyra ekzekutive dhe ekipet tona lokale të përbërë nga koordinatorë, edukatore, aktiviste dhe voluntare. Ekipet tona lokale realizuan katër cikle të punëtorive (gjithsejtë 64 punëtori (32) në fazën e parë dhe (32) në fazën e dytë të projektit) ku merrnin pjesë gjithsej 380 gra, të moshave të ndryshme. Temat të cilat u pranuan ishin: *konceptet gjinore, barazia gjinore, të drejtat e njeriut të grave, lobimi dhe përfaqësimi publik, planifikimi i aksionit lokal dhe përpilimi i planit veprues*. Nëpërmjet këtyre punëtorive pjesëmarrëset kishin mundësi t'i artikulojnë problemet e tyre, të ndërmarrin role individuale dhe grupe për zbatim të aktiviteteve publike në bashkësi, si edhe të ndikojnë në krijimin e ndryshimeve pozitive në nivel individual, në nivel të grupit dhe bashkësisë në përgjithësi. Ekipet tona ishin në ndërvëprim të vazhdueshëm me grupin synues dhe të gjitha palët tjera të prekura në bashkësi, duke përfshirë edhe medie të caktuara. Përkrahja e tyre vazhdoi edhe pas mbarimit të punëtorive edukative. Ata ishin bashkërisht si gjatë kohës së planifikimit, ashtu edhe gjatë kohës së realizimit të një numri të


madh të aktiviteteve – aksione të iniciuara nga ana e grupit synues.

Pas zbatimit të cikleve edukative të cilat kishin për qëllim t'i forcojnë kapacitetet e grave për njohje të koncepteve gjinore dhe zbatimit të praktikave gjinore, grupi synues i rriti njohuritë dhe shkathhtësitë e veta dhe tregoi vetëdije të rritur për njohje të problemeve me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat dhe përcaktimin e prioriteteve të cilat janë në interes të tyre dhe në interes të bashkësisë.


Në kuadër të punëtorive edukative (nga faza e parë dhe e dytë e projektit) u edukuan dhe u përforcuan gjithsej 380 gra në 64 punëtori edukative të cilat më tej merrnin pjesë aktive në planifikimin dhe implementimin e 16 aksioneve lokale me ndjeshmëri gjinore në komunat e tyre.



Struktura etnike e grave pjesëmarrëse në punëtoritë



Struktura e pjesëmarrësve në punëtoritë edukative sipas shkallës së arsimimit



Struktura e pjesëmarrësve në punëtoritë edukative sipas moshës

Aksione lokale

Në përgatitjen dhe realizimin e aksioneve lokale në të dyja^{2 3} fazat e projektit ishte i inkuadruar grupi synues i grave rurale të paki-cave etnike (gjithsej 132 gra të cilat morën pjesë në punëtoritë) i cili funksiononte si rrjet grash dhe kontribuoi për implementimin e aktiviteteve të parapara. Në kuadër të kësaj faze të projektit janë planifikuar dhe realizuar 16 plane lokale për aksion të cilat janë të iniciuara mbi bazën e probleme ekzistuese dhe nevojave të grave, të cilat ata vet i përcaktuan parësore. Aksionet lokale të zbatuara në komunat Mogilë, Tearcë, Likovë, Krushevë, Dibër dhe Gostivar përfshinë tema të llojllojshme në drejtim të: mbrojtjes shëndetësore, edukimit për mbrojtje të shëndetit reproduktiv, informim për varshmëritë të cilat u kërcënohen të rinjve, inkuadrim aktiv në procesin arsimor, dhunën gjinore dhe familjare, jetën stresuese të vajzave të reja, martesave me marrëveshje, mundësitë për vetëpunësim, përforsim të vetëbesimit, e deri në forcimin ekonomik.

Në 16 aksionet lokale, të iniciuara nga ana e grupeve joformale të grave, gjithsej u inkuadruan 1665 persona, ndërsa në kuadër të 128 aktiviteteve të realizuara u zbatuan: 5 anketa për ndjeshmëri


2 Gjatë kohës së realizimit të aktiviteteve të fazës së parë të projektit në komunat e Tearcës, Mogilës, Likovës dhe Krushevës u përfshinë gra të bashkësive të ndryshme etnike nga 21 mjedise rurale: Krushevë – Jakrenovë, Sazhdevë, Borinë, Belushinë dhe Lazhan; Tearcë – Neproshten, Tearcë, Dobrosht, Gillogj, Përshevcë, Odër dhe Sllatinë; Mogillë – Budakovë, Musincë, Mogilë dhe Trap; Likovë – Likovë, Sllupçan, Opajë, Vaksincë dhe Runicë

3 Gjatë kohës së realizimit të aktiviteteve nga faza e parë e projektit në komunat e Mogilës, Dibrës, Tearcës dhe Gostivarit u përfshinë gra nga bashkësitë e ndryshme etnike të 19 mjediseve rurale: Dibër: Mogorç, Broshticë, Xhepishtë, Oris-han; Tearcë: Dobrosht, Nerasht, Odër, Tearcë, Sllatinë, Gillogj, Përshevcë; Mogilë: Mogilë, Ivanjevc, Tërnovc, Budakovë; Gostivar: Çegran, Forinë, Bellovisht, Balin-doll.

gjinore, 44 punëtori edukative, 9 debate publike, 7 TV emisione, 15 fushata mediesh dhe 38 takime punuese (me ekipin lokal, koordinatorët lokalë, vetëqeverisjen lokale dhe me grupin synues), TV video klip me tema kundër dhunës gjinore dhe familjare, 4 tribuna, organizim i pazarit (nga ana e grave të cilat ndoqën trajnim për forcim ekonomik – përpilim të planeve afariste), udhëtim në bashkësi tjetër lokale – në vizitë të biznesmenes grua, 2 aksione publike të iniciuara nga vajzat e reja të cilave u janë bashkëngjitur edhe djem (një tribunë dhe një debat publik).

Komuna të cilat ishin të përfshira me projektin “Nëpërmjet edukimit dhe përforcimit drejt inkuadrimit dhe qytetarisë aktive”


➤ **Komuna e Likovës**



Komuna e Likovës⁴ gjendet në pjesën veriore të Republikës së Maqedonisë, kufizohet me Serbinë dhe Malin e Zi në veri, në lindje me komunën e Kumanovës, në jug me Haraçinën, Gazi Babën dhe Butelin, ndërsa në perëndim me komunën Çuçer Sandevë dhe me Kosovën.

Në Këshillin e Komunës së Likovës ka 18 këshilltarë prej të cilëve 4 janë gra. Komuna ka të formuar Komision për mundësi të barabarta dhe e njëjta

4 Komuna e Likovës përbëhet nga vendet vijuese të banuara: Likovë, Alashevc, Belanovc, Dumanovc, Glaznjo, Gisincë, Izvor, Llojan, Mateç, Nikushtak, Opajë, Orizar, Hotël, Rankovc, Ropalcë, Runicë, Sllupçan, Strazhë, Strimë, Vaksincë, Vishticë dhe Zlokuqan.



e përgatit planin e aksionit për vitin 2011. Në kuadër të aktiviteteve të veta komisioni ka hapur klub për gra këshilltare në komunë, zbaton trajnim për mbrojtje nga diskriminimi dhe lobon për ndërtim

të qendrës ditore për persona me handikap (punohet në hapjen e saj). Komuna e Likovës është komunë rurale, ndërsa popullsia kryesisht merret me bujqësi, biznese të vogla (ferma, punëtori të vogla për përpunimin e qumështit, mulli për bluarjen e grurit etj.), tregti dhe përpunim të drurit. Në kuadër të komunës nuk ka ambulancë gjinekologjike e as spital, por ka ambulanca private. Për arsimimin e fëmijëve kujdesen një çerdhe (e cila është në fazën e ndërtimit), 6 shkolla fillore dhe shkollë e mesme e natës.

Numri i përgjithshëm i popullsisë në komunën e Likovës është 27.058, të cilët janë të përkatësive të ndryshme etnike. Në raport me përkatësinë nacionale pjesa më e madhe është përqindja e shqiptarëve 97,42%, serbëve 1,37%, maqedonasve 0,63% dhe të nacionalitete të tjera 0,56%. Sipas gjinisë, nga ana tjetër, 50,8% janë meshkuj, ndërsa 49,2% janë femra.

Në drejtim të strukturës së popullsisë femërore sipas arsimimit 5,2% (696) nuk kanë arsimim, ndërsa rreth 11,8% (1575) nuk e kanë të mbaruar shkollën fillore, ndërsa arsimim të lartë kanë vetëm 0,6% (79) e femrave. Nga të gjitha femrat që jetojnë në këtë komunë (13.299) të punësuar janë 6,9% (91) femra, ndërsa të papunësuar janë 22,8% (900), respektivisht ekonomikisht aktive 5 janë 29,7% femra.

5 Popullsi ekonomikisht aktive është popullsia e përgjithshme e aftë për punë e cila është e paraqitur në Agjencinë për Punësim (si të punësuar apo të papunësuar) – te femrat ky është kufiri prej 18 deri në 62 vjet.

❖ Aksioni i parë lokal
“Nëpërmjet edukimit deri te jeta më cilësore”

Gjatë ciklit të parë të punëtorive edukative, grupi synues e njohu problemin e edukimit të pamjaftueshëm të grave në temën e shëndetit riproduktiv dhe së këndejmi, ata vendosën që plani i parë i aksionit të ketë të bëjë me vetëdijesimin dhe informimin për mbrojtjen shëndetësore dhe zbulimin e hershëm dhe pengimin e sëmundjeve të organeve të riproduktimit ku ishin të përfshirë gjithsej 81 femër.

Mes aktiviteteve u zbatua një hulumtim i cili përfshinte 100 gra nga fshatrat e Likovës, Sllupçanit, Opajës dhe Vaksincës. Anketimi u realizua nga ana e grupit synues, ndërsa përmbajtja e anketës (pyetjet e anketës) nga ekipi i Antikos në bashkëpunim me ekspertë. Pyetësorët e anketës ishin të analizuar nga ana e ekspertit, e pastaj ishin të publikuara në 180 broshura. Të dhënat e fituara udhëzojnë se femrat kanë informata të mjaftueshme për shëndetin e organeve riproduktive dhe edukimin gjinor, respektivisht 66% janë përgjigjur se kanë informata të mjaftueshme, 14% shumë, ndërsa 20% aspak nuk janë të informuara. Posaçërisht i lartë është numri i atyre grave të cilat mendojnë se të rinjtë nuk janë mjaftueshëm të informuar për edukimin gjinor dhe riproduktimin, andaj sipas tyre shfaqet nevoja e edukimit të vazhdueshëm dhe informimit të popullata e re. Në raport me ekzistimin e institucioneve përkatëse të cilat ofrojnë këshilla në lidhje me planifikimin e familjeve, parandalimi i organeve të riproduktimit, mbrojtja shëndetësore dhe riproduktimi, 33% kanë dëgjuar se ka, por nuk kanë pasur qasje deri te to, ndërsa 23% dinë se ka institucione të tilla. Nga pyetjet tjera të parashtruara mund të përfundohet se institucionet shëndetësore të cilat japin shërbime për parandalim, diagnostikim dhe shërim të sëmundjeve të ndryshme të organeve të riproduktimit janë të vlerësuara pozitivisht, por në esencë problem për gratë e mjedisve rurale paraqet udhëzimi në institucion i cili është larg vendit të tyre ku jetojnë. Në raport me përfshirjen e edukimit seksual në

programin arsimor të intervistuarat mendojnë se është i nevojshëm edukim i vazhdueshëm dhe informim i popullsisë në raport me këto çështje me çka do të ishte rritur parandalimi dhe mbrojtja nga sëmundjet që barten seksualisht dhe shtatzënia e padëshirueshme.

Me qëllim të rritjes së diturive të grupit synues për nevojën e mbrojtjes shëndetësore dhe kontrole parandaluese të organeve të reprodutivitetit të grave u realizuan 3 punëtori edukative me mjekë të përgjithshëm dhe dy gjinekologë ku merrnin pjesë 65gra, si edhe një tribunë në të cilën merrnin pjesë 116 gra. Të gjitha këto aktivitete ishin të përkrahura në aspektin e medieve në TV Festa ku ekipi lokal morri pjesë në programin i cili u emetua në eter 3 herë në ditë.

❖ **Aksioni i dytë lokal “Edhe ne mundemi”**

Si rezultat i ciklit të dytë të punëtorive edukative, me kërkesë të grave të inkuadruara në të njëjtat, aksioni i dytë lokal i zbatuar në komunën e Likovës, kishte për qëllim vetëdijesimin, informimin dhe edukimin për mundësinë për vetëpunësim nëpërmjet shfrytëzimit të kapaciteteve personale të grave. Për këtë qëllim, u organizua hulumtim, ndërsa analiza u publikua në 160 broshura.

Hulumtimi i zbatuar në komunën e Likovës, ku u anketuan femra të moshës 18-50 vjeç, kishte për qëllim të shqyrtohen nevojat e femrave në raport me mundësitë për vetëpunësim nëpërmjet shfrytëzimit të kapaciteteve personale dhe burimeve me të cilat ata disponojnë. Sipas të dhënave të fituara nga ana e të intervistuarve në raport me atë a kontribuojnë me të ardhura personale në familje, një pjesë e madhe e tyre më saktësisht 64% nuk kontribuojnë sepse nuk kanë punë, 21% kontribuojnë sepse janë të punësuar, ndërsa 9% kohë pas kohe kanë punë. Sipas të dhënave në raport me dituritë dhe shkathtësitë të cilat i posedojnë të intervistuarat mund të shqyrtohet se më të përfaqësuara janë vijueset: thurje (22%), qepje dhe prerje (21%), përgatitje e ushqimit tradicional

(20%), qëndisje (13%), kultivimi i kulturave kopshtare (10%), përpunimi me dorë i gjësendeve (9%) dhe të tjera (5%).

Të pyetur si do ta kishin vlerësuar përkrahjen e komunës për zhvillim të bizneseve të vogla 48% mendojnë se komuna është neutrale, 31% negative, 12% shumë pozitive, ndërsa 9% pozitive. Sipas asaj a u nevojiten më shumë informata dhe dije për hapje të biznesit personal 48% e të intervistuarave mendojnë se shumë u nevojiten, 35% mendojnë se kanë informata të mjaftueshme, 15% nuk e dinë, ndërsa 2% të të intervistuarave nuk u nevojiten informata. Femrat e komunës së Likovës mendojnë se nevojitet përkrahje më e madhe nga ana e komunës në drejtim të zhvillimit të programeve për forma të motivimit në raport me forcimin ekonomik të femrës, zhvillimit të veprimtarisë sipërmarrëse dhe zhvillimit rural, donacioneve dhe kredive për përkrahje të femrave.

145 femra nga Likova nëpërmjet 5 punëtorive edukative me ekspertë ekonomike dhe tribunë publike kanë përgatitur dy plane biznesi. Edhe ky aksion lokal ishte i përkrahur në aspektin e medieve nga TV Festa.



➤ **Komuna e Tearcës**

Komuna e Tearcës⁶ është komunë rurale me seli në f. Tearcë. Në pjesën veriore komuna kufizohet me Kosovën, në jug dhe lindje me komunën e Jegunocit, ndërsa në perëndim me Tetovën.



Këshilli i komunës së Tearcës përbëhet prej 19 anëtarëve dhe kryetarit, ndërsa prej tyre 5 janë femra. Në kuadër të komunës ekziston dhe funksionon Komisioni i Mundësive të Barabarta i cili në bashkëpunim me

6 Në përbërje të komunës së Tearcës hyjnë fshatrat: Neproshten, Leshkë, Varvarë, Sllatinë, Brezovë, Tearcë, Përshevcë, Gillogj, Jelloshnik, Dobrosht, Nerasht, Odër dhe Përcë.



organizata ndërkombëtare realizoi projekt për dhunën familjare, dhunë ndaj femrave dhe tregtisë me njerëz.

Popullsia e përgjithshme e komunës arrin 22.454 banorë. Komuna e Teracës është mjedis heterogjen nacional, respektivisht në të jetojnë: shqiptarë (84,39%), maqedonas (12,2%), turq (2,29%), romë (0,23%), serbë (0,03%) dhe të tjerë (0,74%).

Sipas moshës komuna bën pjesë në grupin e komunave më të reja.

Popullsia e kësaj komune kryesisht merret me bujqësi, ndërtimtari, tregti etj. Komuna ka 5 shkolla qendrore dhe 3 periferike, 3 ambulanca shtetërore dhe 3 private, 5 fusha futbollit dhe pallat kulture i cili nuk është në funksion.

Sipas të dhënave të fituara⁷ mund të theksohet se shkallë e më e lartë e analfabetizmit ekziston te popullata femërore prej 7,8% për dallim prej meshkujve prej 2,1%. Në raport me papunësinë të dhënat flasin se përqindja e të papunëve në komunë është e madhe dhe arrin 62%. Në raport me papunësinë te femrat mund të theksohet se (nga numri i përgjithshëm i femrave) ajo përqindje te kjo popullatë është posaçërisht e lartë dhe arrin deri në 68,1%.

❖ Aksioni i parë lokal **“Ruaje shëndetin – ruaje ardhmërinë”**

Qëllimi i këtij aksioni lokal është vetëdijesimi dhe informimi i femrave në raport me mbrojtjen e shëndetit riproduktiv dhe nevojës për kontrolle të rregullta gjinekologjike për ruajtje të të njëjtit.

Në kuadër të këtij aksioni, nga ana e grupit synues, i cili vendo-

⁷ Të dhënat janë fituar nga Bashkëqeverisja Lokale Tearcë

si bashkëpunim dhe fitoi përkrahje nga ana e mjekëve lokalë dhe specialistëve u përgatitën dhe emituan 4 TV emisione edukative në TV Koha në kohëzgjatje prej 15-20 minuta në temën pasojat e sëmundjeve malinje të gjirit, kanceri në qafën e mitrës, normat ligjore për mjekun amë gjinekolog, planifikimit të familjes dhe përdorimi i mjeteve kontraceptive. Bashkëbisedues në TV emisionet ishin mjeku amë, gjinekologu specialist, radiologu, juristi, psikologu, kryetari i komunës së Tearcës si edhe përfaqësues të sektorit të OJQ-s. Këta emisione me përkrahje të TV Koha shumë herë u riemituan dhe përfshinë shikues nga më shumë komuna, sepse Koha është TV medie regjionale.

Për aktualizim të këtij problemi të hidhur të femrave në mjediset rurale, krahas TV emisioneve edukative, u organizuan edhe 4 mbledhje punuese me ekipet lokale, koordinuesen dhe grupin synues dhe 2 takime me kryetarin e Komunës së Tearcës. Krahas kësaj, për masivizim të efektit të aktiviteteve të organizuara u shtypën dhe shpërndanë materiale promovuese në 600 kopje, ndërsa u mbajt edhe një tribunë me 26 femra pjesëmarrëse ku u prezantuan TV emisionet dhe u shpërndanë materialet edukative.

❖ Aksioni i dytë lokal

“Të drejtat e njeriut janë edhe të drejtat e mia”

Aktivitetet në kuadër të këtij aksioni lokal ishin të drejtuara drejt informimit të femrave për njohje dhe kuptim të koncepteve gjinore dhe mbrojtje të drejtave të njeriut të femrave. Me qëllim që të rritet vetëdija e femrave në mjediset rurale për të drejtat e tyre të cilat u janë të garantuara në vend dhe mbrojtja e të njëjtave janë mbajtur 4 punëtori edukative me 123 femra në tema të të drejtave të njeriut të femrave, mekanizmat e mbrojtjes dhe roli e rëndësia e arsimimit, ku ligjërues ishin dy profesorë, ekspertë nga kjo fushë. U organizua një tribunë ku merrnin pjesë 63 femra dhe u distribuua material promovues me përmbajtje nga fusha e të drejtave të njeriut (600 ekzemplarë – 200 në gjuhën maqedonase dhe 400 në gjuhën shqipe).

Në prezantimin medial të aksionit lokal u inkuadruan mediet – TV Kiss, TV Koha dhe TV Art, ndërsa artikuj u botuan në mediet e shtypura Fakti, Koha dhe Lajm, si edhe në ueb faqet e medieve Koha, Lajm dhe RTV Kiss dhe radio Dojçe Vele.

❖ Aksioni i tretë lokal **“I promovojmë shkathtësitë tona”**

Plani i tretë i aksionit lokal i zbatuar në komunën e Tearcës ishte i drejtuar drejt forcimit ekonomik të femrave, respektivisht rritjes së vetëbesimit të tyre dhe përmirësimit të informimit për teknikat për promovim të shkathtësive të tyre dhe prodhimeve të përpunuara në kushte shtëpiake.

Aktivitetet e aksionit lokal kontribuuan që të animohen femrat në procesin e promovimit, prezantimit dhe plasmanit të prodhimeve të cilat ata vetë i prodhojnë, me çka edhe ata do të kontribuojnë për mirëqenien e familjeve të tyre dhe të shoqërisë si tërësi.

Nëpërmjet dy punëtorive edukative 40 femra fituan mundësi të mësojnë më tepër për forcimin ekonomik e me këtë edhe ta fitojnë pavarësinë e tyre. Për promovim të prodhimeve të cilat femrat e grupit synues i përpunojnë me dorë u organizua pazar, i përkrahur dhe në bashkëpunim me vet komunën e Tearcës dhe kryetarin e komunës, në të cilin kishte 69 pjesëmarrës. Krahas kësaj, kjo ngjarje ishte e përkrahur në aspektin e medieve nga TV Art, ndërsa artikuj u botuan në mediet e shtypura Fakti, Koha dhe në ueb faqen www.yllpress.com. Gjithashtu, për aktualizimin e inkuadrimin të femrave në sektorin ekonomik është mbajtur një debat publik ku kanë marrë pjesë 35 pjesëmarrës – kryetari i komunës së Tearcës, subjekte relevante të komunës dhe sektorit të biznesit dhe palëve të tjera të përfshira.

❖ Aksioni i katërt lokal **“Ta shndërrojmë idenë në sukses”**

Si ndërlidhje e aksionit të mëparshëm lokal, në kuadër të këtij plani të aksionit u xhiruan tre filma dokumentarë në kohëzgjatje prej 20 minutash nga ana e TV Art dhe të njëjtat u emetuan në këtë televizion. Filmat kishin karakter edukativ – përmirësimi i gjendjes ekonomike të femrave në komunë nga aspekti i konkurrencës, qasja deri te tregu i punës, vetëpunësimi dhe puna sipërmarrëse dhe informata për politikën dhe masat ekzistuese qeveritare – ndërsa bashkëbisedues ishin ekspertë ekonomikë, femra të suksesshme biznesmene dhe përfaqësues të subjekteve lokale.


Me qëllim që të kenë mundësi nga afër të njihen me suksesin e femrës biznesmene për grupin synues, në bashkëpunim me koordinatoren lokale, u organizua takim me femër sipërmarrëse të suksesshme në komunë. Në këtë mënyrë, femrat u njoftuan me një rrëfim të suksesshëm dhe shkëmbyen përvoja pozitive për zhvillim të veprimtarisë sipërmarrëse dhe mundësive për realizimin e ideve të tyre afariste.

➤ **Komuna e Mogilës**



Komuna e Mogilës është komunë rurale me madhësi të mesme, përfshinë sipërfaqe prej 251,2 km² dhe gjendet në pjesën juglindore të Republikës së Maqedonisë. Mogila shtrihet në rrafshinën e Pellagonisë rreth dhjetë kilometra në verilindje të Manastirit. Komunën e Mogilës e përbëjnë 23 vendbanime.⁸

⁸ Komuna e Mogilës përbëhet prej vendbanimeve vijuese: Mogila, Beranci, Vasharejca, Çarlija e Epërme dhe e Poshtme, Sërpci i Poshtëm, Ivanjevci, Loznani, Novoselani, Podino, Radobori, Sveto Todor, Trnovci, Dobrusheva, Dedebalci, Musinci, Noshpali, Mojno, Alinci, Puturusi, Crniçani, Trapi dhe Budakova.



Këshilli i Komunës numëron 11 anëtarë, ku meshkujt janë të përfaqësuar me 82% (9), ndërsa femrat me 18% (2). Në komunë krahas komisioneve të tjera është formuar edhe Komisioni i Mundësive të Barabarta i cili deri tani nuk ka zbatuar ndonjë aktivitete konkret, por është në kontakt të vazhdueshëm me femrat e komunës dhe si rezultat i kësaj për nevojat dhe kërkesat e tyre

do të iniciojë nismë ato të pranohen në planin aksionar për këtë vit.

Numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Mogilës është 6.710 (53% meshkuj, 47% femra), ndërsa sipas strukturës nacionale përfaqësimi është: maqedonas (95,8%), shqiptarë (0,5%), turq (3,4%), romë (0,1%) dhe të tjerë (0,2%).

Banorët e kësaj komune kryesisht merren me bujqësi dhe blegtori. Në kuadër të komunës ka fabrikë për ushqim të kafshëve në f. Radobar si edhe fermë KB “Pelagonija”. Ekonomitë individuale bujqësore sipas tokës së shfrytëzuar bujqësore janë: drithërat, bimët ushqyese për kafshët, perimet, lulet dhe bimët zbukuruese, pemët, vreshtat dhe të tjera. Situata ekonomike është mesatare, pjesa më e madhe e popullsisë jeton nga prodhimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Në komunë ka tre shkolla qendrore me 16 shkolla fillore periferike. Në sferën e shërbimeve shëndetësore në komunë ka 6 ambulanca private, 3 barnatore, si edhe 3 ordianca private stomatologjike. Në raport me strukturën e popullsisë femërore (3154), përqindja e femrave të punësuara është 13,2% (415), ndërsa thajse 58% (1831) e femrave janë ekonomikisht joaktive. Sipas të dhënave të fituara nga Qendra e Punës Sociale mund të theksohet se analfabetizmi te femrat është në mënyrë të konsiderueshme më i madh dhe arrin 11,1% për dallim prej meshkujve te të cilët ai është 3%.

❖ Aksioni i parë lokal “Për jetë më të lumtur”

Qëllimi kryesorë i këtij plani lokal të aksionit ishte vetëdijesimi dhe motivimi i grave nga mjediset rurale për ndërmarrje të nismave për mbrojtje të shëndetit të reproduktimit. Në kuadër të këtij aksioni është zbatuar anketimi i 110 femrave nga fshatrat Budakovë dhe Trap dhe u përgatit analiza nga ana e ekspertit. Në bazë të të dhënave të fituara nga ana e grave të intervistuar mund të shihet gjendja faktike e grave në raport me shëndetin e reproduktimit, si edhe nevojat e tyre në raport me mbrojtjen dhe parandalimin e të njëjtës. Së këndejmi, mund të përfundohet se thujtse gjysma e të intervistuarave nuk janë mjaftueshëm të informuara në raport me shëndetin reprodutiv, ndërsa pjesën më të madhe të informatave e fitojnë nëpërmjet konsultimit të drejtpërdrejtë me mjekun, bisedat me të afërmit dhe mediet. I lartë është edhe numri i femrave të cilat mendojnë se të rinjtë nuk janë mjaftueshëm të informuar për edukimin gjinor dhe reprodutimin dhe nevojën e edukimit të vazhdueshëm të tyre. Në raport me institucionet shëndetësore të cilat japin shërbime për parandalim, diagnozë dhe shërim të sëmundjeve të ndryshme të organeve të reprodutimit problem për femrat e mjedisve rurale paraqet largësia e institucionit nga vendi i tyre i të jetuarit. Kjo tregon se një pjesë e madhe e femrave për shkak të largësisë së institucionit shëndetësor nuk kryejnë kontrollime të rregullta për mbrojtje të shëndetit reprodutiv. Gjithashtu, sipas të dhënave të fituara, do të mund të përfundojmë se gjysma e të intervistuarave nuk kanë gjinekolog amë dhe shkojnë në kontrollime gjinekologjike vetëm sipas nevojës që, nga ana tjetër, tregon se në kushte të tilla mjeku vetëm mund të japë diagnozë për problemin shëndetësor tanimë të krijuar, por nuk mund të veprojë në mënyrë parandaluese. Në raport me futjen në funksion të arsimit seksual në programin mësimor, 81% thekson se nevojitet kjo, me çka vërtetohet nevoja e edukimit të vazhdueshëm dhe informimit të popullsisë në raport me këto çështje.

Në kuadër të këtij aksioni lokal të zbatuar në komunën e Mogilës

janë përfshirë gjithsej 108 gra. Prej aktiviteteve, janë realizuar dy punëtori edukative në temën mbrojtja e shëndetit riprodiktiv ku merrnin pjesë gjithsej 47 gra, ndërsa në rolin e edukatorëve u angazhuan mjek i përgjithshëm, radiolog dhe gjinekolog. U mbajt edhe një tribunë ku merrnin pjesë 51 grua, ndërsa ngjarja ishte e përkrahur në aspektin e medieve nga TV Tera lokale. U shpërndanë 800 ekzemplarë të materialeve promovuese dhe edukative (400 në gjuhën maqedonase dhe 400 në gjuhën turke).

❖ **Aksioni i dytë lokal “Për jetë pa dhunë”**

Nëpërmjet këtij aksioni lokal u përforcuan kapacitetet e 81 gruaje nga komuna e Mogilës për njohje, ballafaqim dhe ndërmarrje të nisave për problemin e dhunës familjare.

Për aktualizim të problemit dhe gjetjes eventuale të zgjidhjeve për viktimat e dhunës familjare janë zbatuar dy punëtori edukative në temën “Stop për dhunën familjare” në të cilat në mënyrë aktive kanë marrë pjesë 40 femra, ndërsa ishin të ndihmuara nga ana e punëtorit social dhe dy inspektorëve nga njësia rajonale e MPB-së.

U realizua edhe një tribunë ku merrnin pjesë 41 grua, ndërsa e njëjta në aspektin e medieve u përkrah nga TV Tera në material që u emetua në lajmet e ditës.

❖ **Aksioni i tretë lokal** **“Edukim për mbrojtje të shëndetit** **të riprodiktimit të grave në Mogilë”**

Në kuadër të këtij aksioni lokal u mbajtën 2 punëtori edukative me 57 pjesëmarrëse në temën “Përmirësimi i shëndetit riprodiktiv” dhe një forum në të cilin ishin të pranishëm 50 femra të cilat iniciuan diskutim për qasjen deri te institucionet përgjegjëse për shëndetin riprodiktiv të grave, informimin e pamjaftueshëm, problemet me të cilat ballafaqohen dhe zgjidhjet e mundshme për tejkalimin e tyre.

Për aktualizim më të gjerë të problemit dhe theksimin e rëndësisë së shëndetit reproduktiv u shtyp dhe u shpërnda material edukativ në 400 kopje në gjuhën maqedonase dhe turke.

❖ Aksioni i katërt lokal
“Të mirinformuar, më mirë të mbrojtur”
inicuar dhe realizuar nga ana e grupit synues

Aksioni lokal përfshinte pjesëmarrje të vajzave të reja dhe grave të cilat gjithnjë e më tepër janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të cilat i mbajnë trendët e rinj dhe mënyrat e të jetuarit. Për këtë qëllim, ishin realizuar 6 punëtori edukative në temën e varshmërive – sëmundjeve të së sotmes dhe mbrojtjes nga shtatzënia e padëshiruar dhe sëmundjet që barten seksualisht, ndërsa në mënyrë aktive morën pjesë 174 persona. Ligjëratat u udhëhoqën nga ana e ekspertëve gjinekologë dhe kryetarja e njësisë rajonale të SPB Manastir.


Për nevojat e këtij aksioni lokal u shtypën dy lloje të afisheve edukative në 600 ekzemplarë (në gjuhën maqedonase dhe turke) – i pari i përfshinte mënyrat e mbrojtjes nga shtatzënia e padëshiruar dhe sëmundjet që barten seksualisht, ndërsa i dyti parandalimi dhe mbrojtja nga varshmëritë.

➤ **Komuna e Krushevës**



Komuna e Krushevës⁹ është e vendosur në pjesën jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë. Kufijtë e komunës shtrihen në qytetin e Krushevës i cili luan rol qendror në komu-

9 Në kuadër të komunës së Krushevës bëjnë pjesë vendbanimet vijuese: Krusheva, Aldanci, Arileva, Belushina, Borina, Buçini, Divjaci i Poshtëm dhe i Epërm, Jakrenova, Milosheva, Norova, Ostrilci, Presli, Pusta Reka, Sazhdeva, Selca, Svelto Mitrani dhe Vrboeci.



nën e lartpërmendur dhe i cili paraqet qendër administrative, ekonomike dhe kulturore. Popullsia në komunën e Krushevës është e përbërë nga më shumë nacionalitete: maqedonas, vllleh, shqiptarë, boshnjakë, turq dhe romë.

Në komunën e Krushevës ka 11 anëtarë këshilli, prej të cilëve 4 janë femra. Në kuadër të statutit të komunës ekzistojnë më shumë komisione punuese në këshillin komunal mes të cilëve është edhe Komisioni i Mundësive të Barabarta i cili është themeluar kohë më parë. Edhe krahas kësaj, ai ka përgatitur plan lokal aksioni i cili përfshinë më shumë fusha: edukim dhe informim të rinjve për sëmundjet që barten seksualisht, edukim të femrave në mjediset rurale, themelim të bizneseve të vogla nga ana e grave (respektivisht vetëpunësimit të tyre), kujdesi për personat e moshuar dhe mbrojtje të mjedisit jetësor. Sipas përfaqësuesve të institucionit kompetent, KMB-ja në kuadër të mundësive të veta (resurseve njerëzore dhe materiale), punon në implementimin e aktiviteteve nga plani i aksionit.

Ekonomia në komunë nuk është e zhvilluar. Mes sektorëve ekonomikë në komunë, fushë më e rëndësishme është turizmi. Në mjediset rurale gruri, perimet dhe pemëtaria dominojnë në prodhimtarinë bujqësore, ndërsa te blegtoria dominon kultivimi i dhenve dhe kafshëve të mëdha.

Përqindja e popullsisë të aftë për punë në qytetin e Krushevës është 66,4% nga popullsia e përgjithshme, ndërsa vetëm 40% e popullsisë të aftë për punë është në marrëdhënie pune. Ky numër nuk është faktik sepse ndryshohet vazhdimisht, ndërsa, nga ana tjetër, gratë e mjedisve rurale shpesh nuk regjistrohen si të papuna.

Familjet të cilat merren me turizëm dhe bletari, nuk janë të regjistruara sepse nuk i plotësojnë kriteret, ndërsa nga ana tjetër, ata të

mjediseve rurale kryesisht merren me bujqësi dhe blegtori dhe kjo u paraqet ekzistencë themelore.

Në kuadër të komunës funksionon një çerdhe, dy shkolla fillore, një shkollë e mesme dhe një qendër ditore për përkujdesje të fëmijëve me nevoja të veçanta. Pjesa më e madhe e grave të këtyre mjediseve rurale nuk kanë kryer shkollë të mesme. Në drejtim të shëndetësisë komuna e Krushevës ka një shtëpi shëndeti, por në të nuk ka ambulancë gjinekologjike.

❖ Aksioni i parë lokal **“Shëndeti i femrës – shëndet reproduktimi”**

Aksioni i parë lokal i cili u zbatua në komunën e Krushevës kishte për qëllim ta përmirësojë informimin e grave për mbrojtjen e shëndetit të reproduktimit dhe ta risë përgjegjësinë e tyre në raport me parandalimin dhe kujdesin e rregullt të të njëjtës.

Për situatat në terren në raport me shëndetin e reproduktimit (me nismë të grupit synues të projektit të Antiko-s) është realizuar hulumtim në të cilin ishin përfshirë 200 gra nga fshatrat Borinë, Sazhdevë, Belushinë dhe Jakrenovë. Ky hulumtim tregoi se numri i madh i të intervistuarave mendojnë se janë mjaftueshëm të informuara në raport me shëndetin reproduktiv, por kanë qëndrime të ndryshme në raport me informimin e të rinjve për edukimin gjinor dhe reproduktimin. Kjo tregon se në të ardhmen duhet të hapen këto çështje për diskutim dhe të shqyrtohet rëndësia e edukimit dhe informimit të vazhdueshëm të popullata e re. Problemi kryesor i femrave të mjediseve rurale është ai që drejtohen në institucion i cili është larg vendit të tyre të jetuarit. Të dhënat të cilat janë fituar nga ana e femrave çojnë në përfundimin se një përqindje e madhe (70,7%) kanë zgjedhur gjinekolog amë që do të thotë se ekziston interes te femrat që të kujdesen për shëndetin e tyre. Megjithatë, kur të shqyrtohen të dhënat në raport me atë se ato do të drejtohen në kontroll gjinekologjik vetëm në rast nevoje dhe kur kanë probleme shëndetësore, sjell deri te përfundimi se shumë

pak veprohet në parandalim. Për këtë arsye, nevojitet që femrat vazhdimisht ta ndjekin shëndetin e tyre reprodutiv dhe të ngrihet vetëdija te ta në raport me këtë çështje. Nga aspekti i bisedimeve për sëmundjet që barten në mënyrë seksuale dhe kontracepsioni, sipas rezultateve të fituara mund të përfundohet se këto tema nuk diskutohen në mënyrë të hapur në familje dhe ende paraqesin tabu dhe prandaj nevojitet informim, hapje dhe diskutim më i madh për këto çështje te popullsia e përgjithshme.

Në këtë aksion lokal ishin të zbatuara 4 punëtori edukative me ekspertë gjinekologë në temën njohja dhe shërimi adekuat i sëmundjeve të organeve të reprodutimit ku morën pjesë 101 femër. Njëkohësisht, u organizua edhe një tribunë me 22 pjesëmarrëse në temën mbrojtja e shëndetit reprodutiv.

Për promovimin dhe aktualizimin e problemeve dhe nevojave të cilat dolën nga ky aksion lokal u shtypën dhe shpërndanë 2000 ekzemplarë të materialeve promovuese dhe edukative.

❖ Aksioni i dytë lokal **“Arsimimi i femrës në shekullin 21”**

Nëpërmjet këtij aksioni lokal 102 femra të zonave rurale të komunës e forcuan vetëdijen për nevojën për arsimim dhe e përmirësuan informimin e tyre për përparësitë e edukimit si pjesë e jetës bashkëkohore shoqërore dhe pasojat e mungesës së arsimimit që shprehet edhe ndaj cilësisë së jetesës së individëve.


Që të përcaktohet gjendja në teren u zbatua anketimi i rreth 100 femrave nga fshatrat Borinë, Sazhdevë, Belushinë dhe Jakrenovë dhe u përgatit analiza nga ana e ekspertit. Gjatë realizimit të anketës në pyetjen pse nuk kanë vazhduar me shkollimin pjesa më e madhe e të intervistuarave janë përgjigjur se kjo ka ndodhur për shkak të ndikimit të traditës (34,7%), për shkak të obligimeve familjare (18,8%), mospasja e mjeteve financiare (18,8%), martesë e hershme (16,8%) dhe të tjera (4%), ndërsa përgjigje në pyetjen nuk kanë dhënë aspak (6,9%). Numri më i madh i të intervistuarave

ve respektivisht (62,4%) janë shprehur se mentaliteti i popullsisë dhe tradita kanë ndikim të madh në raport me shkallën e arsimit të femra, me çka vërtetohet fakti se ende mentaliteti patriarkal nuk është ndryshuar në raport me edukimin të gratë, veçanërisht në mjediset rurale. Pjesëmarrëset në anketë theksojnë se pengesat në të cilat hasin gjatë procesit arsimor janë largësia e shkollës (34,7%), mospasja e mjeteve financiare (37,7%) dhe vështirësi me transportin (12,9%). Në raport me pyetjen a do të donin ta riformojnë, vazhdojnë dhe risin nivelin e arsimit të tyre 33,7% u përgjigjën se do të kishin dashur nëse kanë kushte, 25,7% nuk e dinë dhe për atë vendim është e nevojshme të bisedojnë me familjen, 21,8% aspak nuk janë të interesuara, ndërsa përgjigje pohuese kanë dhënë 11,9%. Kjo e dhënë tregon se femrat e mjedisve rurale në thelb dëshirojnë ta vazhdojnë arsimimin e tyre, por është e nevojshme të kenë të siguruara kushte, ose të fitojnë përgjigje pozitive dhe përkrahje nga familjet e tyre. Shumë i ulët është numri (vetëm 11,9%) i vajzave të cilat mundën të pavarura të vendosin dhe të thonë se në këtë fazë të jetës së tyre, nëse krijohen kushte dhe mundësi do ta kishin vazhduar arsimimin e tyre (të ndërprerë).


Në temën e arsimit joformal, arsimit alfabetik dhe funksional u mbajtën 4 punëtori edukative (ku morën pjesë gjithsej 71 grua) dhe një tribunë ku morën pjesë 31 grua. Me qëllim që të përfshihet pjesë më e madhe e popullsisë rurale u shtypën dhe shpërndanë materiale promovuese dhe edukative në 1400 ekzemplarë prej të cilave 700 në gjuhën maqedonase dhe 700 në gjuhën shqipe.

➤ Komuna e Dibrës

Territori i komunës së Dibrës¹⁰ shtrihet në Maqedoninë Perëndimore, krahas vet kufirit me Republikën e Shqipërisë. Qyteti gjendet në lartësi mbidetare 630 – 700 metra dhe e përfshinë fushën e Dibrës, mes luginave të malit Krçin, Liqenit të Dibrës dhe luginës së Lumit Drini i Zi. Komuna e Dibrës kufizohet me komunat e Rostushit, Qendrës Zhupa, Strugës dhe linjës së kufirit shtetëror me Republikën e Shqipërisë.



■ Meshkuj
■ Femra



■ Shqiptarë
■ Turq
■ Maqedonas
■ Romë
■ Të tjerë

Këshilli i komunës së Dibrës numëron 15 këshilltarë prej të cilëve 3 janë femra. Në kuadër të komunës është formuar Komisioni i Mundësive të Barabarta mes femrave dhe meshkujve dhe është caktuar person koordinator për mundësi të barabarta, por të njëjtat nuk kanë zbatuar aktivitete më të rëndësishme.

Në bazë të regjistrimit të fundit të vitit 2002 komuna e Dibrës ka 24.251 banorë. Këtu jeton popullsia e nacionaliteteve të ndryshme: maqedonas (13,6%), shqiptarë (49%), turq (31%), romë (4,4%) dhe të tjerë (2%).

Në komunën e Dibrës ka 19 shkolla fillore dhe një shkollë të mesme. Shkalla e analfabetizimit të femrave arrin 4,5%, ndërsa përqindja e arsimit të kryer të popullsisë së përgjithshme është si vijon: 54,9% kanë arsimim fillor, 22,1% të mesëm dhe 3,9% arsimim të

¹⁰ Komuna e Dibrës përbëhet prej vendbanimeve vijuese: Dibër, Banjisht, Bommovë, Kosovrast i Epërm dhe i Poshtëm, Xhepisht, Gari, Hame, Konjarë, Krivcë, Mogorç, Osoj, Otishan, Rajçicë, Selokuqi, Spas, Tatar Elevc, Trnjanik, Broshticë

lartë. Për shëndetin e qytetarëve në këtë komunë, nga ana tjetër, kujdesen 7 ambulanca për mjekësi të përgjithshme, një mjekësi të punës, një shërbim për mbrojtje shëndetësore për fëmijë (0-6) dhe një shërbim për mbrojtje shëndetësore të fëmijëve shkollorë dhe të rinjve.

Një pjesë e popullsisë së komunës së Dibrës është në kurbet, ndërsa të tjerët merren me bujqësi, blegtori dhe punojnë në hidrocentralin “Shpilje” dhe fabrikën për prodhimin e gipsit “Knauf”. Shkalla e papunësisë në komunë¹¹ arrin 60,4%, ndërsa prej tyre 36,4% janë femra. Prej popullsisë femërore të aftë për punë aktive janë 28,2%, ndërsa joaktive 71,8%.

❖ Aksioni i parë lokal
“Martesat e marra vesh të vajzave të mitura
– pengesë reale për realizimin e të drejtave të njeriut dhe
barazinë gjinore”

Në mjediset rurale të komunës së Dibrës, e posaçërisht në fshatrat Mogorç dhe Broshticë ekziston fenomeni i premtimit të hershëm i cili është shumë serioz dhe kompleks, me çka kërcënohen të drejtat themelore të njeriut veçanërisht të fëmijëve të gjinisë femërore që në rininë e tyre të hershme nga ana e prindërve të tyre. Në fakt, premtimi i hershëm i lidhjes së martesave të marra vesh mes fëmijëve femër dhe mashkull nga ana e prindërve të tyre është pengesë serioze në realizimin e të drejtës së tyre për arsimim respektivisht mbarim të suksesshëm të arsimimit të mesëm dhe ambicieve të mëtutjeshme në jetë. Me qëllim që të vihet theks më i madh në këtë fenomen shumë diskriminues, të mbrohen të rinjtë nga kjo dukuri e cila ka pasoja negative në zhvillimin e tyre dhe jetën e mëtutjeshme, grupi synues bashkërisht me ekipet lokale të Antiko-s, realizuan aksion lokal me aktivitete të vazhdueshme,

¹¹ Sipas të dhënave të marra nga “Të dhëna dhe indikatorë për komunat në Maqedoni”, 2004, e botuar në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Statistikës, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe UNDP.

të cilat dhanë kontribut që të veprohet paralelisht në ngritjen e vetëdijes publike si te vajzat dhe djemtë e rinjtë, ashtu edhe te prindërit e tyre dhe publiku i përgjithshëm. Për realizimin e këtij qëllimi u organizuan 3 punëtori edukative dhe 2 tribuna me gjithsej 151 pjesëmarrës.

Nëpërmjet edukimit të realizuar pjesëmarrësit erdhën deri në përfundim se kjo dukuri është posaçërisht e dëmshme dhe i shkel të drejtat e vajzave sepse ajo është edhe pengesë dhe nuk jep mundësi ta vazhdojnë arsimimin e tyre, të fitojnë vetëbesim më të madh dhe pavarësi ekonomike. Ata nuk kanë të drejtë të sjellin vendime në pajtueshmëri me vullnetin personal dhe afinitetet, nuk kanë të drejtë për zgjedhjen e tyre për partnerin e tyre martesor dhe janë të kufizuara që në moshën më të hershme në sjelljen e pavarur të vendimeve për trupin dhe jetën e tyre.

Për përfshirje të gjithanshme më të madhe të edukimit, në kuadër të këtij aksioni lokal, u shtypën 1000 afishe në të cilat informatat për këtë problem aktual kanë të bëjnë jo vetëm me vajzat, por edhe me djemtë dhe prindërit e tyre.

❖ Aksioni i dytë lokal


“Edukimi për shëndetin e reproduktimit, parakusht për jetë cilësore dhe familje të shëndoshë”

Njohja e pamjaftueshme, mosekzistimi i vetëdijes për mbrojtje të shëndetit të reproduktimit dhe nevojës për sjellje të përgjegjshme seksuale të meshkujve dhe femrave janë tematika kryesore e cila u përfshi në përgatitjen dhe realizimin e aksionit të dytë lokal në komunën e Dibrës, e iniciuar dhe e realizuar nga grupi synues.


Janë zbatuar 4 punëtori në të cilat morën pjesë 113 pjesëmarrës, ndërsa edukatorë ishin sociolog dhe gjinekolog. Në kuadër të aktiviteteve nga ky aksion u realizua edhe takim me kryetarin e komunës të cilit iu paraqitën propozimet si të zgjidhen pengesat me të cilat femrat ballafaqohen për çdo ditë në drejtim të mbrojtjes shëndetësore.

➤ Komuna e Gostivarit

Komuna e Gostivarit¹² gjendet në pjesën skajore jugore të fushës së Gostivarit dhe paraqet qendër kryesore administrative, drejtuese, politike, ekonomike dhe kulturore në Pollogun e Epërm. Qyteti i Gostivarit dhe rrethina gjenden në rritje të vazhdueshme dinamike ekonomike dhe demografike.



■ Meshkuj
■ Femra



■ Shqiptarë
■ Maqedonas
■ Turq
■ Romë
■ Të tjerë

Në kuadër të këshillit të komunës së Gostivarit është formuar Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave dhe është caktuar koordinator për mundësi të barabarta. Prej numrit të përgjithshëm të këshilltarëve, 31, prej të cilëve 9 (29%) janë femra, ndërsa 22 (71%) janë meshkuj. Komisioni ka përgatitur plan aksioni, por implementimi i aktiviteteve zhvillohet me vështirësi për shkak të mungesës së financave (buxhetit gjinor).

Sipas të dhënave statistikore të regjistrimit të fundit të vitit 2002 popullsia e përgjithshme në këtë komunë është 81.042 banorë. Prej tyre meshkuj janë 49,4%, ndërsa femra 50,6%. Në këtë komunë shumetnike jetojnë nacionalitete të ndryshme: maqedonas (19,5%), shqiptarë (66,6%), turq (9,8%), romë (3,8%) dhe të tjerë (3,3%).

12 Komuna e Gostivarit përbëhet prej vendbanimeve vijuese: Gostivari, Balindolli, Bellovishti, Brodeci, Çajleja, Çegrani, Debreshi, Padalishti, Peckova, Banjica e Poshtme dhe e Epërme, Gjonovica e Poshtme dhe e Epërme, Jelovca e Poshtme dhe e Epërme, Forina, Raveni, Reçani, Simnica, Sërmnova, Korita, Kunova, Llakavica, Lesnica, Turçani i Vogël, Merdita, Mitroj Krsti, Strajani, Vërtoku, Tërnova, Tumçevishti, Zdunja, Zhelezna Reka.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal në raport me strukturën e popullsisë së përgjithshme (nuk ka të dhëna të sugjeruara për gratë) në komunën e Gostivarit sipas arsimimit numri më i madh i femrave kanë arsimim fillor 56,9%, të mesme kanë 19,6%, të lartë 3%, ndërsa magjistra ka vetëm 0,1%. Në këtë komunë ka 61 shkolla fillore dhe 4 të mesme.

Banorët e kësaj komune më së shumti merren me bujqësi dhe blegtori, ndërsa disa prej tyre punojnë në industri ose kanë ndërmarrje të tyre private. Numri i familjeve të cilat merren me bujqësi dhe blegtori arrin 18.780. Numri i personave të papunë në komunën e Gostivarit arrin 9.450 prej të cilëve 6.756 (71,5%) janë meshkuj, ndërsa 2.594 (28,5%) të tjerë janë femra. Shkalla e aktivitetit ekonomik të femrave arrin vetëm 15,6% (respektivisht joaktive janë 84,4%).

❖ Aksioni i parë lokal **“Dhuna, armë e të dobëtëve!”**

Aksioni lokal kishte për qëllim ta ritë nivelin e ndjeshmërisë, kupimit dhe njohjes së shfaqjes së dhunës familjare te femrat e mjediseve rurale; përcaktimin e indikatorëve themelorë për shfaqjen e dhunës familjare dhe forcimin e vetëbesimit te femrat dhe inkurajimin e tyre për ndërmarrje të hapave për paraqitje dhe mbrojtje nga dhuna.

Për arritjen e këtij qëllimi u realizuan dy punëtori edukative dhe një forum publik në të cilat në mënyrë aktive merrnin pjesë 50 persona. Për promovim të ngritjes së vetëdijes publike të femrave në komunë dhe publikut të gjithëmbarsuem, në kuadër të aksionit lokal, të iniciuar dhe të realizuar nga ana e grupit synues në bashkëpunim me ekipet lokale të Antiko-s, u krijua edhe **video klip** i cili u shfaq në TV Kiss regional me kohëzgjatje prej 10 ditëve, duke u shfaqur në kohë me shikueshmëri të lartë tre herë në ditë.

❖ Aksioni i dytë lokal “Jeta stresuese e vajzave të reja”

Ky aksion lokal e trajton problemin me shfaqjen e stresit te vajzat e reja, që në masë të madhe varet nga rolet e gjinive të imponuara nga familja dhe shoqëria. Për edukimin e vajzave të reja si të ballafaqohen me stresin i cili del nga rolet e pabarabarta të gjinive u organizuan 2 punëtori në të cilat merrnin pjesë rreth 42 pjesëmarrëse. Edukatorët e punëtorive ishin dy ekspertë nga fusha e psikologjisë. Stereotipat për rolet e gjinive shpesh janë burim për shfaqjen e stresit te femrat e reja.

Si rezultat i edukimit u iniciuan çështjet për atë se rolet, raportet gjinore dhe edukimi stereotip patriarkal dhe vlerat në të cilat janë të ekspozuar fëmijët nga lindja e tyre, kushtëzon që djemtë shpesh të jenë dominues, më agresivë dhe t'i fshehin emocionet e tyre. Kjo mënyrë e edukimit stereotip ndikon që fëmijët meshkuj të kenë fuqi më të madhe në raport me vajzat.

Vajzat që nga fëmijëria e hershme i mësojnë se duhet të jenë të dëgjueshme, të përkushtuara ndaj shtëpisë dhe familjes, pasive etj. Ky është një shembull tipik i ekzistimit të shkallës së lartë të vlerave patriarkale në këto mjedise të cilat e kushtëzojnë dhe e mbajnë pabarazinë gjinore, e cila krahas që i diskriminon vajzat dhe femrat, shumë negativisht reflektohet edhe ndaj shëndetit të tyre psiko – fizik. Njëra nga pasojat e shpeshta të kësaj gjendjeje është shfaqja e **stresit** te vajzat e reja.

Nëpërmjet debatit publik me të rinjtë dhe profesorët e tyre, është rritur informimi për shfaqjen e stresit. Ata u njohën me arsyet dhe pasojat e stresit, si edhe metodat e parandalimit dhe mbrojtjes. Fokusi u vendos në ngritjen e vetëdijes publike për rrënjët e problemit të shikuar nga **dimensionin gjinor**.

Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes lokale

Njëri nga elementet shumë të rëndësishme të këtij projekti i cili dha rezultate të posaçme ishte vendosja e bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale. Ekipi i projektit të Antiko-s, ekipet tona lokale edukative, anëtare, bashkëpunëtoresh, voluntarët/voluntaret – anëtarë të rrjetit të Antiko-s në këtë bashkësi lokale, dhanë kontribut të madh në realizimin e njërit nga shumë qëllimet dhe detyrat e rëndësishme të këtij projekti. Në fakt, ata ishin katalizatorë mes grupit synues – femrave të bashkësive etnike joshumicë të mjedisve rurale – dhe pushtetit lokal dhe instancave të tjera me rëndësi vendimmarrëse në bashkësi.

Me institucionet dhe autoritetet lokale – kryetarin e komunës, komisionet gjinore, këshilltarët dhe këshilltaret e këshillave komunalë vendosëm bashkëpunim. Me kryetarët e komunave nënshkruam 6 Memorandume vjetore për bashkëpunim. Organizuam takime të përbashkëta, debate dhe punëtori, ku grupet synuese i njohën ata me problemet dhe nevojat e femrave në bashkësitë e tyre. Gjithashtu, grupet synuese përpiluan dhe shtypën “Manifest” me problemet dhe nevojat e identifikuara dhe dhanë propozime dhe kërkesa konkrete për zgjidhje të të njëjtave. Nëpërmjet kësaj mënyre të realizimit të bashkëpunimit dhe veprimit u mundësua përkrahje e përbashkët e femrave të zonave rurale nga aspekti i përmirësimit të pozitës së tyre në bashkësi dhe inkuadrimit më të madh të tyre në jetën publike dhe në krijimin e politikave lokale gjinore.

Ekipi koordinues dhe lokal i Antiko-s realizoi 12 takime pune me kryetarët e komunave, këshilltarët, koordinatorët dhe anëtarët e komisioneve për mundësi të barabarta në 6 komuna: Mogilë, Likovë, Tearcë, Krushevë, Gostivar dhe Dibër.

Mbledhjet punuese kontribuuan që përfaqësuesit e komunave ta rrisin vetëdijen për situatën dhe nevojat e femrave në bashkësitë e tyre lokale dhe treguan vullnet politik t'i përkrahin planet në raport me këtë çështje. Ata, gjithashtu, treguan edhe interes për

bashkëpunim në raport me çështjet femërore me prioritet dhe dhanë përkrahje morale dhe logjistike për realizimin e aktiviteteve gjatë zbatimit të projektit dhe ndërmarrjen e aksioneve të grupit joformal të grave (grupit synues të projektit).

Si të arritura më të rëndësishme (praktika të mira) do t'i kishim theksuar edhe të arriturat vijuese të këtij bashkëpunimi të vendosur:

-Grupi joformal i femrave të NJBL Krushevë gjatë procesit të identifikimit të problemit dhe përgatitjes së manifestit, si prioritet e veçoi problemin e mosekzistimit të **ordinancës gjinekologjike** në Krushevë, ndërsa me këtë edhe pamundësia për kontrole të rregullta gjinekologjike. Kërkesat e tyre ata i dorëzuan deri te vetëqeverisja lokale por njëkohësisht nëpër një proces të lobimit dhe përfaqësimit publik, të organizuar vepruan të pranohen kërkesat e tyre (edhe pse kjo nuk do të thotë zgjidhje e tërësishme e problemit) me atë që e organizoi transportin dhe kontrollimin preventiv gjinekologjik të rreth 300 femrave të mjediseve rurale, në institucione gjinekologjike në qytetin e Prilepit.

-Vetëqeverisja lokale e pranoi propozimin e femrave nga komuna e Mogilës për hapje të **Këshillimores për Shëndet Reproductiv**. Në fazë të përpunimit është Plani Lokal i Aksionit për barazi gjinore për vitin 2011 në të cilin duhet të inkorporohet edhe ky propozim si aktivitet i Komisionit për Mundësi të Barabarta (KMB). Grupi joformal i femrave dhe ekipi koordinues janë në komunikim të vazhdueshëm me pushtetin lokal, veçanërisht me KMB-në, me qëllim që më tej të sigurohen të gjitha kushtet dhe mjetet për realizim praktik të propozimit.

-Është formuar **lobi grup joformal** "Klubi i grave" – në komunën e Tearcës i cili ka për qëllim të punojë në identifikimin e problemeve të grave në bashkësi, zbatim të aktiviteteve nga fusha e problematikës gjinore, lobim dhe përfaqësim të të drejtave të grave.

Njëkohësisht, vetëqeverisja lokale e Tearcës e pranoi propozimin e femrave për hapje të çerdhes së fëmijëve. Propozimi është

inkorporuar në programin e komunës, kështu që në vijim është realizimi i tij praktik. Komuna i realizon të gjitha obligimet administrative rreth ndërtimit, lokacioni është përcaktuar dhe nevojitet edhe një leje nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve që të fillohet me ndërtimin. Mjetet për këtë projekt do të sigurohen nga buxheti i komunës dhe Ministria përkatëse e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa pritet edhe përkrahje nga donacione ndërkombëtare dhe vendore. Kjo paraqet shembull shumë të mirë (praktikë të mirë) të përfaqësimit publik për krijim të politikave të ndjeshme gjinore dhe buxhet gjinor, si rezultat i bashkëpunimit të vendosur të sektorit civil (Antiko), iniciativës së qytetarëve (grupi synues i Anktiko-s) dhe pushteti lokal (Komuna e Tearcës).

-Si rezultat i aktiviteteve të “Klubit të grave” është ngritur nismë e re në komunën e Tearcës për hapjen e Shtëpisë së Personave të Moshuar (propozimi ende shqyrtohet nga ana e pushtetit komunal dhe nuk ka informatë kthyesë për vendimin).

Përshtypja e përgjithshme nga bashkëpunimi i gjertanishëm me pushtetin lokal në gjashtë komunat është se ekziston vullnet dhe dëshirë e mirë, pikërisht për shkak të faktit që disa prej problemeve të femrave janë aq të qarta dhe të dukshme në bashkësi. Nevojitet të bëhen strategji të vazhdueshme, të koordinuara dhe të planifikuara mirë dhe aktivitete për vetëdijesim dhe motivim gjinor, si edhe të vendoset bashkëpunim ndërsektorial mes të gjithë aktorëve relevantë në bashkësi. Me këta rezultate të arritura, u tregua se aktivitetet të cilat u iniciuan janë tërësisht të arsyeshme dhe të dobishme jo vetëm për femrat, por edhe për bashkësitë lokale në përgjithësi.

Mungesa e financave, burimeve materiale dhe kuadrit të edukuar janë dobësitë më të shpeshta me të cilat ballafaqohen komunat, e të cilat më tej paraqesin pengesa që të ndërmerren aksione të cilat në periudhë afatgjate do t'i kishin zgjidhur problemet ekzistuese. Por, edhe krahas kësaj, ne presim bashkëpunim që të vazhdojë, që si plotësim kërkon angazhim të mëtutjeshëm dhe përpjekje, posaçërisht për femrat e **grupeve të porsaformuara lokale**.

Si shembull pozitiv do ta kishim veçuar përkrahjen e kryetarëve të komunave të Tearcës, Mogilës dhe Likovës, si gjatë periudhës së implementimit të aksioneve lokale, ashtu edhe pas mbarimit të aktiviteteve projektuese edhe atë në domenin e shëndetit të reprodutimit dhe përforcimit ekonomik të femrave.

Rrjete lokale të grave të përfshira

Grupet joformale të grave të formuara në periudhën e zbatimit të aktiviteteve projektuese, vazhduan të veprojnë në bashkësitë e tyre lokale edhe pas mbarimit të projektit në pajtueshmëri me kushtet dhe mundësitë, edhe pse intensiteti i aktivizimit të tyre dallohet nga komuna në komunë.

Para së gjithash, në të 6 vetëqeverisjet lokale femrat edhe më tej mbajnë mbledhje, me qëllim që të diskutojnë për problemet aktuale, të shkëmbejnë mendime dhe të marrin qëndrime të caktuara për çështje të cilat i prekin femrat. Grupet joformale të femrave rregullisht komunikojnë dhe konsultohen me koordinatore të ekipet lokale, me përkrahje të cilëve i dorëzojnë kërkesat deri te bashkëqeverisja lokale.

Në periudhën vijuese si aktivitete më të rëndësishme të grupeve joformale të grave do t'i kishim veçuar:

-U ngrit iniciativa nga ana e grupit joformal të grave në komunën e Gostivarit për formimin e organizatës joqeveritare. Për shkak të përkrahjes së nevojshme logjistike dhe instruksioneve rreth procesit të regjistrimit të OJQ-së, gratë janë në komunikim edhe me shoqatën Qendra e Grave – Gostivar.

-Në komunën e Likovës gratë tanimë kanë formuar dy organizata joqeveritare të cilat punojnë në fushën e barazisë gjinore. Nga ana e disa grave të grupit joformal janë përgatitur plane biznesi për të cilat pritet, nëpërmjet programeve qeveritare ose donatorëve të caktuar, të sigurohen mjete për realizimin e tyre. Gjithashtu, vazhdohet me edukimin e grave për shëndet reprodutiv që kontribuoi që numri i grave të cilat kanë vizituar gjinekolog të rritet për 10%.

-Grupi joformal i grave nga komuna e Mogilës vazhdon me aktivitetet për informimin e grave për shëndetin riproduktiv. Vet gratë u organizuan dhe kërkuan ndihmë nga vetëqeverisja lokale për organizimin e transportit deri te institucionet shëndetësore për shkak të kontrollimeve gjinekologjike – pap teste dhe mamografi. Grupi joformal tregoi interes të organizojë ligjërime për gratë, për parandalimin dhe mbrojtjen nga varshmëritë, sepse në kuadër të aksionit lokal në këtë temë punohej vetëm me të rinjtë.

-Në komunën e Tearcës edhe më tej vëmendje më të madhe i kushtohet forcimit ekonomik të grave. Pas mbarimit të aktiviteteve të zbatuara në kuadër të aksioneve lokale, gratë të organizuara në “Klubin e grave”, insistojnë që dituritë e fituara t’i zbatojnë në praktikë dhe të sigurojnë përkrahje nga institucionet kompetente dhe pushteti lokal në gjetjen e moduleve për vetëpunësim dhe materializim të punës së tyre.

Konferencë përmbyllëse e projektit **“Nëpërmjet edukimit dhe forcimit drejt** **inkuadrimit social dhe qytetarisë aktive”**

Konferenca e cila u mbajt më 24.02.2011 paraqiste sublimim, respektivisht një rumbullakësi të punës dyvjeçare me gratë e zonave rurale dhe kishte për qëllim të inkurajohen pjesëmarrësit (përfaqësues të bashkësive lokale, Komisioneve për Mundësi të Barabarta, gratë lokale nga mjediset rurale, organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare) t’i ndajnë përvojat dhe qëndrimet e tyre dhe të shkëmbejnë praktika të mira të cilat në të ardhmen do të kontribuojnë për forcimin e vetëdijes ekonomike dhe inkuadrimit social të grave nga mjediset rurale, si edhe zgjidhje praktike për përmirësim të pozitës së gruas në shoqërinë tradicionale patriarkale.

Në konferencë ishin të pranishëm 54 pjesëmarrës, të cilët morën pjesëmarrje aktive në diskutim dhe në bazë të përvojave, qëndrimeve dhe propozimeve të tyre u sollën rekomandime të cilat duhet të merren parasysh në punën e mëtejshme:

- 1. Të dhënat duhet të jenë të ndara sipas gjinisë.** Konferenca i përshëndet përpjekjet në nivel qendror për ndarje të të dhënave, por sugjeron që praktika e njëjtë të bartet edhe në nivel të qendrave regjionale zhvillimore dhe komunave.
- 2. Alarmante** është përqindja e grave nga zonat rurale të cila kanë mbaruar vetëm arsimimin fillor, që paraqet pengesë funksionale për inkuadrim të plotë dhe tërësor në rrjedhat moderne të shoqërisë. Me shpresë për përmirësim të gjendjes nëpërmjet zbatimit të arsimit të obligueshëm të mesëm, konferenca i thërret sjellësit e vendimeve t'i kushtojnë vëmendje edhe këtij grupi synues dhe i njëjti të riorsimohet nëpërmjet mundësive të cilat dalin nga Ligji për arsimim të të rriturve dhe mësimi të përgjithshëm.
- 3. Rezultate të qëndrueshme dhe afatgjata** arrihen vetëm nëse sigurohet inkuadrim i të gjitha palëve të përfshira dhe të prekurra nëpërmjet koordinimit vertikal dhe horizontal. Posaçërisht i jepet guxim bashkëpunimit mes rrjeteve joformale të grave dhe Komisioneve për Mundësi të Barabarta në nivel lokal, të cilat nëpërmjet një procesi të koordinimit të bashkëpunimit me gratë, nevojave dhe interesimeve të identifikuar mund t'i inkuadrojnë në planet lokale të aksionit për barazinë gjinore.
- 4. Nxitet** vazhdimisht inkuadrimi dhe përfshirja e femrave të reja, por edhe e meshkujve. Inkurajohet organizimi i tyre në forma të ndryshme të veprimit me qëllim të përcaktimit dhe përfaqësimit më të lehtë të çështjeve të cilat i prekin të dy gjinitë.
- 5. Në vazhdimësi** duhet të informohet publiku më i gjerë për sfidat me të cilat ballafaqohen gratë e mjediseve rurale me qëllim të sensibilizimit dhe edukimit të publikut. Posaçërisht është e rëndësishme të informohen dhe të mbahen relacione dhe konsultime të rregullta me kreatorët e politikave/përfaqësuesve në strukturat e vendosjes në nivel nacional dhe lokal, sepse pikërisht një pjesë e masave dhe politikave të cilat i sjellin dhe i zbatojnë, mund të kenë ndikim edhe ndaj shkallës së avancimit

të barazisë gjinore në zonat rurale.

- 6. Forcimi ekonomik** i grave është njëra nga veglat më të fuqishme për avancimin e pozitës së gruas. Kjo arrihet nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të vet grave dhe inkuadrimin e tyre aktiv në tregun e punës, por edhe nëpërmjet krijimit të kushteve për lirim të gruas nga shumë punë të papaguara të cilat i kryejnë në shtëpi.
- 7. Popullsia e shëndoshë është popullsi produktive**, në Maqedoni rreth 42% e popullsisë jeton në mjediset rurale, andaj nevoja e sigurimit të qasjes deri te shërbimet cilësore shëndetësore është shumë e madhe. Këtu theks të posaçëm u vendoset kontrollimeve gjinekologjike të cilat për fat të keq ose janë vështirë në dispozicion për gratë e mjediseve rurale, ose në raste të tjera nuk ekziston vetëdije për parandalim të rregullt dhe mbrojtje.

Strategji dhe sfida të suksesshme

- Gjatë zbatimit të aktiviteteve projektuese për arritje të qëllimeve të planifikuara të projekteve dhe rezultateve të pritura, ekipi zbatoi strategji pune e cila mundësoi:
 - Gratë e mjediseve rurale u vetëdijesuan, fituan njohuri, përvoja, shkathtësi dhe aftësi për planifikim, veprim të organizuar, lobim, përfaqësim publik dhe përcaktim të dimensionit gjinor të aktivizimit të tyre femëror;
 - E përforcuan identitetin e tyre, fuqinë dhe vetëbesimin, nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellë dhe pjesëmarrjes aktive në procesin e planifikimit, përgatitjes dhe implementimit të aktiviteteve të aksioneve lokale;
 - Mësuan t'i identifikojnë problemet dhe prioritetet e grave në bashkësi dhe t'i inkorporojnë në "manifest", të cilin pastaj e dorëzuan deri te pushteti lokal;
 - E rritën motivimin dhe morën guxim për formim të rrjeteve joformale, nëpërmjet inkuadrimin të faktorëve vendimmarrës të

tjerë në bashkësi;

- Nëpërmjet punës aktive me grupet e femrave u tejkaluan stereotipa të caktuar ekzistues, paragjykime si edhe barriera personale dhe grupe të cilat i bëjnë gratë të jenë të ndjeshme dhe të marginalizuara;
- Ky projekt edhe njëherë dëshmoi se metodologjia e punës të cilën e zbaton IQF Antiko në punën e saj (edukim – përkrahje – aksion) është njëra prej më të vështirave, por njëkohësisht edhe metodat më të qëndrueshme të punës të cilat japin rezultate konkrete dhe me grupet më të marginalizuara në bashkësi. лтати и со најмаргинализираните групи во заедниците.

Ekipe lokale të IQF Antiko, të cilat e njohin mirë konstruktin mental të popullsisë në bashkësitë lokale ku veprojnë, shfrytëzuan qasje dhe metodologji ndëraktive të pranueshme dhe të përshtatur me kontekstin dhe nevojat e grupit synues. Kjo mënyrë e veprimit e ndihmoi procesin e ndërtimit të besimit të ndërsjellë dhe motivimit dhe mundësoi pjesëmarrje aktive të grupit synues në aktivitetet në nivel lokal. Qasja “nga dera në derë” u tregua si mënyrë efektive dhe e drejtpërdrejtë e komunikimit me grupet synuese dhe familjet e tyre, sepse procesi i gjatë i udhëheqjes së bisedave dhe ndërveprimit mundësuan t’u sqarohen domethënia dhe përfitimet të cilat gratë do t’i kenë nëse inkuadrohen në aktivitetet. Gratë u motivuan të dalin nga shtëpitë e tyre dhe në mënyrë të hapur të flasin për problemet me të cilat ballafaqohen.

Si rezultat i cili e vërteton strategjinë e shfrytëzuar me kujdes është nënshkrimi i 6 Memorandumeve për bashkëpunim me komunat e Mogilës, Krushevës, Likovës, Tearcës, Gostivarit dhe Dibrës. Dorëzimi i Manifestit deri te komunat nga ana e femrave, në të cilin janë përfshirë propozime dhe kërkesa për përmirësim të pozitës së tyre, paraqet mundësi që të shqyrtohen problemet ekzistuese të femrave dhe nevoja për ndërmarrje të zgjidhjeve sistemore dhe sistematike për tejkalim të të njëjtave.

Manifestet u shqyrtuan nga ana e autoriteteve komunale të cilët treguan vullnet të mirë, kështu që disa nga kërkesat u pranuan dhe u inkorporuan në programin e vetëqeverisjes lokale. I tillë ishte rasti me kërkesën për ndërtim të çerdhes së fëmijëve në Tearcë, pranimi i propozimit të hapet Këshillimore për Shëndet Reprodaktiv në komunën e Mogilës dhe organizim të kontrollimeve gjinekologjike falas të grave nga mjediset rurale nga komuna e Krushëvës. Njëkohësisht, përfaqësuesit e pushtetit lokal treguan përgatitje edhe në periudhën vijuese, në pajtim me mundësitë e komunës, të bëjnë përpjekje dhe të realizojnë propozime të caktuara, të cilët nga ana tjetër, do të kishin ndikim pozitiv ndaj cilësisë së jetës së grave në bashkësi de qasjes deri te shërbime të caktuara.

Bashkëpunimi mes vetëqeverisjes lokale dhe sektorit joqeveritar është shumë i rëndësishëm, veçanërisht në raport me krijimin e politikave për përmirësim të pozitës së grave të bashkësive rurale. U tregua se komunikimi dhe kuptimi janë të domosdoshme edhe në interes të të dyja palëve.

-Indikatorë për qasjen e suksesshme dhe strategjinë e zbatuar janë rezultatet e arritura: planifikimi, përgatitja dhe realizimi i 16 planeve lokale aksionare me gjithsej 1665 persona të përfshirë në aktivitete dhe 128 aktivitete të ndryshme të realizuara:

- 5 anketa
- 44 punëtori edukative
- 9 debate publike
- 6 TV emisione
- 14 fushata mediesh
- 38 mbledhje punuese (me vetëqeverisjen lokale, me ekipin lokal, me koordinatore lokale, me grupin synues)
- TV video klip
- 4 tribuna
- Bazar
- 2 aksione publike të iniciuara nga të rinjtë
- vizitë e gruas biznesmene

Rekomandime për hapa të ardhshëm

Publikimi i broshurës ka për qëllim të kontribuojë drejt ndarjes së informatave mes palëve të ndryshme të prekura për përmirësim dhe gjetje të zgjidhjeve përkatëse për veprim të mëtutjeshëm aktiv në raport me inkuadrimin më të madh social të grave të pakicave etnike të cilat jetojnë në mjediset rurale.

Si një dokument gjithëpërfshirës i cili ka karakter informativ dhe edukativ, broshura do t'u jetë në dobi të gjithë palëve të interesuara nga aspekti i qasjes metodologjike në punën me grupe të ndjeshme synuese dhe animimi i tyre në bashkësi. Presim që ky projekt të jetë inspirim për krijim të programeve të reja dhe aktiviteteve të cilat do të jenë bazë për kalim në një fazë më të avancuar në procesin e inkluzionit social të grave të bashkësive rurale.

Përfitimet e materialit dokumentar (raportet dhe praktikrat e mira), të cilat i posedojmë si burim shumë i rëndësishëm kanë rëndësi të shumëfishtë për organizatën tonë, por edhe në OJQ-të anëtare të rrjetit të Antiko-s dhe shfrytëzues të tjerë të cilët do të donin t'i shfrytëzojnë:

-Raportet nga tereni përmbajnë të dhëna nga burime të ndryshme zyrtare në dispozicion, por edhe të dhëna dhe përvojë e fituar drejtpërdrejtë nga puna jonë në terren në nivel lokal dhe nacional në raport me gjendjen faktike të grave të pakicave etnike në komunitat e Mogilës, Tearcës, Dibrës, Krushevës, Gostivarit dhe Likovës, kushtet në të cilat jetojnë, qasja deri te shërbimet dhe mundësitë për zhvillim. Këta të dhëna mund të shfrytëzohen për identifikim të problemeve dhe për nevojat e femrave në këto bashkësi dhe të jenë bazë për inicim të nismave dhe aksioneve për përfaqësim publik, me qëllim të tejkalimit të dobësive ekzistuese dhe krijim të kushteve për përmirësim të statusit të femrave.

-Përmbajtja e prezantuar në broshurë tregon për komunikimin e vazhdueshëm – bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave mes aktorëve kryesorë në bashkësi (gratë si shfrytëzues fi-

nal, sektori qytetar, pushteti lokal dhe institucionet). Kjo qasje çon drejt suksesit për shkak të faktit që mundëson zgjidhje afatgjate dhe sistematike të problemeve, ndërsa secila palë e përfshirë ka përparësi të caktuara. Me fjalë të tjera, subjektet kyçe plotësohen varësisht nga kompetencat e tyre, fusha e veprimit, bartin specifikat e tyre, përvoja dhe vështrime për problemin që kontribuon drejt përzgjedhjes së masave dhe zgjidhjeve përkatëse dhe efikase për tejkalimin e tij.

Qasja deri te **grupet synuese** u tregua si efektive, për shkak se drejtpërdrejtë u komunikua me gratë dhe familjet e tyre (sipas parimit “derë më derë”), u prezantuan aktivitetet, qëllimet dhe përfitimet të cilat do t’i kenë jo vetëm gratë, por edhe anëtarët e tjerë të familjeve, nëse gratë angazhohen dhe ndërmarrin hapa të jenë përbërës aktivë në bashkësi.

Së këndejmi femrat kanë mundësi së pari t’i ndiejnë ndryshimet, ndërsa pastaj edhe t’i bartin më gjerë në bashkësi. Ata i vlerësuan kapacitetet personale – vlerat dhe aftësitë, me çka e ritën vetëbesimin. Ishin të përfshirë në mënyrë aktive në të gjitha fazat e projektit (planifikim, implementim, evaluim) – punonin në identifikimin e problemeve, kaloi procesi i edukimit, inkuadrimin dhe promovimit të aktivizimit afektiv qytetar nëpërmjet zbatimit të llojeve të ndryshme të aktiviteteve, e deri te lobimi dhe përfaqësimi publik për zgjedhjen e problemeve të tyre. Kjo kontribuoi gratë të dalin nga shtëpitë e tyre dhe të ndehen qytetare të rëndësishme dhe të barabarta të cilat në mënyrë të barabartë kontribuojnë në bashkësi si edhe burrat.

Rekomandimet e dala nga konferenca përfundimtare, të përmbledhura në bazë të diskutimit konstruktiv të pjesëmarrësve, hapin mundësi për detektim të fushave kyçe në të cilat duhet të fokusohen palët e prekura në periudhën e ardhshme:

-Sigurimi i të dhënave të përcaktuara në bazë të gjinisë dhe analizë gjinore të gjendjeve në mjediset rurale;

-Edukim i grave dhe i burave në mjediset rurale;

-Përmirësimi i nivelit arsimor të grave në mjediset rurale dhe sigurimi i qasjes së përmirësuar deri te institucionet arsimore;

-Qasje e përmirësuar deri te shërbimet sociale dhe shëndetësore;

-Inkuadrim i grave në proceset ekonomike nëpërmjet vetëpunësim-it dhe rritjes së konkurrencës së tyre në tregun e punës.

Procesin të cilin Antiko e filloi në vitin e largët 1999 si iniciativë e grave – grup joformal i iniciuar nga pjesëmarrëset në seminarin “Gratë në ndërtimin e paqes dhe shoqërisë civile në R. e Maqedonisë” vazhdon edhe më tej. 25.000 femrave dhe meshkujve të gjertanishëm të cilët morën pjesë në aktivitetet e iniciativave të Antiko-s iu bashkëngjiten edhe 1665 persona me këtë projekt. Përpjekjet tona vazhdojnë dhe lëvizin drejt rrugës së realizimit të misionit tonë dhe vizionit...

**Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO
Shkup, Shkurt 2011**